



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E SHTIMES
MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA
INFORMISANJE

Data/Datum/Date:	19.2.2026
Nr./Br./No	02/147
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Shtimes-kryesuesi Rrahman Jakupi
Përmes/Preko/Through:	z. Qemajl Aliu, kryetar i Komunës së Shtimes
Nga/Od/From:	Vlora Hyseni, kordinatore e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
Lënda/Predmet/Subject:	Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Shtimes ka zhvilluar gjashtë mbledhjet e parapara gjatë vitit 2025 si dhe dy mbledhje të jashtëzakonshme, me qëllim sigurimin e një mjedisi të qetë dhe stabil për qytetarët e kësaj komune.

Raporti është bazuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit si dhe Planit Vjetor të Punës dhe përmbledh temat kryesore të trajtuara në gjashtë mbledhjet e mbajtura gjatë vitit 2025.

Me vendim të Kryetarit të Komunës së Shtimes z. Qemajl Aliut për themelimin e KKSB në Shtime me nr:prot 02/40 dt: 23.01.2025 më dt: 24.01.2025 është caktuar mbajtja e mbledhjes së jashtëzakonshme e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në të cilën u diskutua një pikë e vetme e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i situatës së krijuar pas dhunës së shkaktuar nga S.S

Mbledhja u hap nga nënkryetari i komunës Faruk Beqa, me konstatimin e listës së anëtarëve të pranishëm. U sigurua kuorumi i nevojshëm për vazhdimin e punës dhe mbledhja vijoi sipas pikës së vetme të rendit të ditës.

Në fund të kësaj mbledhjeje, anëtarët e KKSB-së dolën me një konkluzion.

1. Nxënësit e klasës së gjashtë S.S dhe A.J të kthehen në shkollën e mesme të ulët “Emin Duraku” në Shtime, meqë shkollimi fillor dhe i mesëm dhe i ulët është i detyruar sipas ligjit nr. 2002/2 mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë.
2. Të obligohen prindërit e nxënësve në fjalë, që t’i dërgojnë dhe t’i marrin nga shkolla. Në asnjë mënyrë të mos pranohet prezenca e tyre, në hyrje dhe dalje të shkollës, pa praninë e prindërve, në të kundërtën nga rojtari i shkollës të lajmërohet Policia e Kosovës dhe të njëjtit të qëndrojnë në objekt deri të jetë prania e PK-së.
3. Nga data 3 shkurt 2025, nxënësi S.S të rivijon mësimin, në klasën ku edhe më parë ka vijuar, ndërsa nxënësi A.J të dërgohet në një klasë tjetër të së njëjtës shkollë.
4. Brenda institucionit shkollor, të monitorohet në vazhdimësi gjatë pushimit të shurt dhe të gjatë, sjellja e të dy nxënësve nga kujdestarët e ditës.
5. Gjatë pushimit të gjatë në pushimin e gjatë, sjelljet e nxënësve të sipërpërmendur të vëzhgohen me kujdes, nga rojtari i shkollës si dhe nga sektori i policisë në komunitet.
6. Të monitorohet nga QPS, procesi i trajtimit psikologjik-klinik i nxënësve të lartpërmendur dhe prindërve të tyre, si dhe QPS të ketë bashkëpunim me shkollën gjatë procesit të këtij monitorimi
7. KKSB, pret informatë mujore nga dikasterët përkatës (Shkolla, QPS dhe PK), lidhur me procesin e monitorimit të sjelljeve të nxënësve në fjalë dhe të dërgohet informata në fund të çdo muaji kalendarik të koordinatori i KKSB-së.

Po ashtu, me vendim të Kryetarit të Komunës së Shtimes z. Qemajl Aliut, me Nr:prot 02/217 dt: 03.03.2025 më dt: 10.03.2025 është caktuar mbledhja e parë e rregullt e KKSB, që kishte këtë rend dite

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.12 2024;
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;
3. Përfshirja e qytetarëve në procesin e reduktimit të dhunës dhe varësisë nga droga - organizimi i tribunave për edukim dhe për rëndësinë e raportimit;
4. Të ndryshme

Komandanti i Stacionit Policor në Shtime raportoi mbi gjendjen e sigurisë në komunë, duke theksuar se situata është stabile dhe nën kontroll, pa ndonjë incident të madh që mund të shqetësojë komunitetin.

Gjatë diskutimeve, anëtarët trajtuan çështje të tjera që prekin qytetarët e komunës, duke përfshirë temat e përditshme dhe shqetësimet që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve. Mbledhja e parë e KKSB-së u karakterizua nga diskutime konstruktive dhe informime të detajuara mbi fushat përkatëse, duke kontribuar në transparencë dhe bashkëpunim të mirë mes institucioneve dhe qytetarëve

Më 5 maj 2025, është mbajtur mbledhja e dytë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Shtimes.

Gjatë kësaj mbledhjeje të cilën e udhëhoqi nënkryetari i Komunës së Shtimes, Faruk Beqa, u shqyrtuan çështje të rëndësishme lidhur me sigurinë në Komunën e Shtimes.

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 10.3.2025;
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;
3. Siguria ushqimore (kontrolli i cilësisë, kushteve dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore);
4. Të ndryshme

Komandanti i Stacionit Policor, Haxhi Behluli, informoi mbi gjendjen e sigurisë në komunë, duke e vlerësuar atë si mjaft stabile. Ai bazohej në statistikat e së njëjtës periudhë kohore të vitit të kaluar dhe gjithashtu prezantoi edhe masat e ndërmarra për parandalimin e dhunës në familje, duke theksuar përkushtimin e Policisë së Kosovës për të ruajtur sigurinë publike.

Mbledhja u mbyll me zotimin e anëtarëve të KKSB-së për të vazhduar punën në ruajtjen e sigurisë dhe zhvillimin e një mjedisi më të sigurt për qytetarët e Komunës së Shtimes.

Më 22 maj 2025, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajti edhe një mbledhje të jashtëzakonshme, e cila kishte një pikë të vetme të rendit të ditës: Shqyrtimin e situatës së krijuar për rastin e Shqiprim Llugagjiut, në të cilën mbledhje KKSB nxori një konkulzion, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ku rekomandoi:

1. Dërgimi urgjent i Shqiprim Llugagjiut në institucion Forenzik Psikiatrik për trajtim të specializuar.
2. Marrja e masave ligjore për trajtim afatgjatë dhe monitorim të gjendjes së tij.
3. Bashkëpunim i ngushtë ndërmjet drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Policisë dhe Prokurorisë për menagjimin e këtij rasti.
4. Ndërhyrje urgjente nga Ministria e Shëndetësisë për trajtim në institucionet psikiatrike të specializuara.
5. Garantimi i sigurisë dhe qetësisë në komunitetin e Shtimes, duke parandaluar incidente të rënda në të ardhmen.

Më 20 qershor 2025, u mbajt mbledhja e tretë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Shtimes, të cilën po ashtu e udhëhoqi nënkryetari i Komunës së Shtimes, Faruk Beqa.

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 5.5.2025;
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;
3. Siguria ushqimore (kontrolli i cilësisë, kushteve dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore);
4. Informatë nga Njësia Profesionale për Zjarrëfikje dhe Shpëtim në Shtime;
5. Informatë nga Drejtoria e Arsimit;

6. Të ndryshme

Pas shqyrtimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nga përfaqëues të Stacionit Policor në Shtime, u dha informata për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes, gjendje kjo që sipas tyre u cilësua stabile dhe e qetë.

Mbledhja më pas vazhdoi nga Komandanti i Njësisë profesionale për Zjarrëfikje dhe Shpëtim, Bajram Gashi, i cili njoftoi që kanë filluar fushata vetëdijësuese, ku në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit, kanë mbajtur edhe ligjërata vetëdijësuese për rastet e zjarrit dhe fatkeqësive natyrore. Deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit të kaluar sipas komandantit të NJPZSH-së, kanë patur 54 intervenime, ndërsa këtë vit, deri më datën 20, 59 intervenime.

Informatën nga drejtoria e Arsimit e dha Udhëheqësi i Sektorit të Arsimit, Lulzim Sahiti, i cili njoftoi gjerësisht për punët dhe aktivitetet që kanë zhvilluar gjatë këtij gjashtë mujori.

-Në mbledhjen e VII-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Shtimes, pike e rendit të ditës ishte edhe raporti gjashtëmujor i Këshillit Komunal për Siguri të Bashkësi. Raporti është bazuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit si dhe Planit Vjetor të Punës dhe përmbledhi temat kryesore të trajtuara në tri mbledhjet e rregullta dhe dy mbledhjet e jashtëzakonshme të mbajtura gjatë këtij gjashtëmujori.

Më 29 shtator 2025, u mbajt mbledhja e katërt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Shtimes.

Në këtë mbledhje, u diskutuan çështjet bazuar në rendin e ditës si më poshtë:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 20.6.2025;
2. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin Janar-Qershor 2025
3. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;
4. Informatë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
5. Informatë nga Drejtoria e Arsimit
6. Të ndryshme.

Mbledhja filloi me shqyrtimin dhe miratimin e Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 20 qershor 2025.

-Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Shtimes.

Komandanti i Stacionit të Policisë në Shtime, Haxhi Behluli, raportoi për gjendjen e sigurisë në komunë, duke theksuar se situata cilësohet e qetë. U prezantuan rastet e ndodhura gjatë periudhës së fundit, të cilat janë trajtuar nga autoritetet përkatëse.

-Informatë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Besnik Ahmeti, informoi anëtarët e KKSB-së për procesin e dëgjimeve buxhetore dhe kërkesat e qytetarëve gjatë këtyre dëgjimeve. Ai ndau detaje mbi menaxhimin financiar dhe prioritetet e komunës për periudhën në vijim.

-Të ndryshme.

Në pikën e fundit, të pranishmit trajtuan çështje të tjera të ndryshme, duke theksuar rëndësinë e vazhdimit të bashkëpunimit për forcimin e sigurisë dhe mirëqenies në komunë.

Mbledhja përfundoi me një angazhim të përbashkët për zgjidhjen e sfidave dhe ruajtjen e sigurisë në komunë.

Mbledhja e pestë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) u mbajt më datën 5 nëntor 2025. Gjatë kësaj mbledhjeje, u shqyrtuan disa çështje të rëndësishme lidhur me sigurinë në Komunën e Shtimes.

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 29.9.2025;
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;
3. Siguria ushqimore (kontrolli i cilësisë, kushteve dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore);
4. Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja e hershme për parandalimin e radikalizimit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm;
5. Të ndryshme

Komandanti i Stacionit Policor në Shtime, informoi anëtarët e KKSB-së për gjendjen e sigurisë në komunë, e cila krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u vlerësua më stabile dhe e qetë. Policia e Kosovës vazhdon të monitorojë dhe ndërmarrë masa për parandalimin e krimeve dhe mbajtjen e rendit në qytet.

Informatën për Sigurinë ushqimore (kontrolli i cilësisë, kushteve dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore), e dha inspektori Ilir Fejzullahu, i cili informoi se vetëm gjatë vitit 2024 kanë hartuar rreth 70 procesverbale, me 12 aktvendime dhe 8 gjoba. Propozim përmbarimi kanë patur 2 dhe shuma e gjobave ka qenë rreth 6 mijë euro. Ndërsa në gjashtë-mujorin e parë të vitit 2025 kanë patur rreth 20 procesverbale, 4 me aktvendime dhe 4 me gjoba. Propozim përmbarimi 2 dhe në përgjithësi vërehet një vetëdijësim më të lartë nga bizneset që operojnë në komunën tonë, duke pasur parasysh se inspektimet dhe njësitë për siguri janë shumë më shpesh në inspektime të bizneseve

Ndërsa për pikën: Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja e hershme për parandalimin e radikalizimit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm, u tha se fatmirësisht si komunë qëndrojmë mirë dhe nuk është paraqitur ndonjë rast apo ndonjë pikë që paraqet rrezik nga ekstremizmi.

Sipas përfaqësuesve të policisë, në lidhje me këtë temë nuk ka asnjë të dhënë zyrtare të paraqitur në komunën tonë.

Më 22 dhjetor 2025, u mbajt mbledhja e gjashtë dhe e fundit për këtë vit e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Shtimes.

Mbledhja u zhvillua sipas rendit të ditës së përcaktuar dhe trajtoi disa çështje me rëndësi për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve.

Rendi i Ditës dhe Diskutimet:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 05.11.2025;
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;
3. Kontrolli, shpërndarja dhe ndalesat për mjetet piroteknike;
4. Raport nga QKMF "Dr. Vezir Bajrami", Shtime;
5. Të ndryshme

Komandanti i Stacionit Policor, Haxhi Behluli, prezantoi një raport mbi gjendjen e sigurisë në komunë, duke e vlerësuar atë si mjaft stabile. Ai bazohej në statistikat e raportit 11-mujor të vitit 2025 dhe prezantoi masat e ndërmarra për parandalimin e dhunës në familje, duke theksuar përkushtimin e Policisë së Kosovës për të ruajtur sigurinë publike.

Albulenë Emini, inspektore e mjedisit, informoi mbi urdhëresën që është nxjerrë për kontrollin dhe ndalimin e shpërndarjes së mjeteve piroteknike. Ai theksoi rëndësinë e ndërgjegjësimit të qytetarëve për rrezikun që paraqesin këto mjete, veçanërisht gjatë festave të fundvitit.

Anëtarët e KKSB-së diskutuan tema të ndryshme, duke përfshirë rekomandimet për përmirësimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe përgatitjet për sfidat e vitit të ardhshëm.

Sfidat dhe Shqetësimet

Komuna e Shtimes, përmes angazhimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ka trajtuar në vazhdimësi çështje që lidhen me sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve. Në mbledhjet e rregullta janë identifikuar disa prej sfidave kryesore që kërkojnë vëmendje dhe bashkëpunim të gjerë shoqëror. Ndër shqetësimet më të theksuara mbetet parandalimi i dhunës në familje dhe forcim i mekanizmave institucionale për trajtimin e rasteve.

Po ashtu, menaxhimi i mbeturinave dhe ndotja mjedisore vazhdojnë të paraqesin sfida, duke kërkuar edhe vetëdijësim më të madh publik.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe identifikimit dhe ndërhyrjes së hershme për parandalimin e radikalizimit dhe ndikimit të lajmeve të pavërteta, si dhe rrezikut nga përdorimi i pakontrolluar i mjeteve piroteknike, sidomos gjatë festave.

Të gjitha mbledhjet e KKSB-së janë udhëhequr nga nënkryetari i komunës, Faruk Beqa, i cili ka luajtur rol të rëndësishëm në funksionimin dhe koordinimin e këtij mekanizmi.

Sipas monitoruesve të KKSB-së, Komuna e Shtimes veçohet si shembull pozitiv për komunat tjera në Kosovë, si në organizimin e mbledhjeve, ashtu edhe në qasjen konstruktive ndaj vendimeve. Përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërinstitucional, komuna vazhdon të dëshmojë se puna e koordinuar sjell rezultate konkrete.

Diskutimet e detajuara mund të gjenden në procesverbalet e publikuara në uebfaqen zyrtare të Komunës së Shtimes.